



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni IV

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 03 .**

Prishtinë, më 19.01.2015 në ora 20:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Saša Milosavljević, Agim Ceku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Milka Vuletic, Slavko Simić, Jasmina Živkovic, Ćerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Munguan: Fisnik Ismaili dhe Blerim Shala.

Nga pjesëmarrësit e tjerë: përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, zyrtare e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Saša Milosavljević, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua e vetmja pikë e rendit të ditës:

- 1. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, me amendamentet e propozuara të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.**

Kryesuesi –. Në fjalën e tij tha se për ditën e sotme është caktuar shqyrtimi i këtij projektligji në procedurë të përsheptuar.

E njoftoi Komisionin se është anëtar edhe në komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe shtoi se i njëjti ka mbajtur mbledhje urgjente ku janë propozuar dhe miratuar dy amendamente , me tekstin si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 2, pas fjalës ‘ Ligjit ‘ shtohet fjala ‘bazik’

Amendamenti 2

Neni 3, riformulohet si vijon:

Neni 41 paragrafi 1, i Ligjit bazik, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

1. Gjykata lëshon vendim për fillimin e procedurave të likuidimit në bazë të Ligjit të ndryshuar për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pas kalimit të periudhës prej tetëmdhjetë (18) muajsh nga afati maksimal i lejuar me Nenin 22 të Ligjit bazik dhe me pajtim me Neni 2 të këtij Ligji dhe, në rast se edhe pas këtij afati:

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, si dhe amendamentet shtesë: 1 dhe 2.

Pas konsultimeve, Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Mbledhja përfundoi në orën 20:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sasa Milosavljevic